

STATUTI
I SHOQERISE "ALBAXHEM"



KREUI

Neni 1

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Shoqeria "ALBAXHEM" sh.p.k., është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Përgjegjesi të Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga persona fizikë, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbejne, kapitalin e regjistruar të shoqerise. Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Çdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri. Çdo ortak ka te drejta vote ne përpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij. Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 2

Themeluesit

Z.Xhemail Fazliu, atesia Hajriz, dtl. 05.05.1965, lindur dhe banues ne Gjilan, Kosove, i paisur me e Republikës Kosovës, me nr P00620013, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ..

Znj.Albana Dervishi, atesia Justinian, me datelindje 01.09.1984. lindur në Berat dhe banuese në adresën: Rruga "Muhamet Deliu", Tiranë, e pajisur me Letërnjoftim ID me Nr Personal:1459010064N.

Neni 3

Selia

Shoqeria do t'a kete seline ne adresen: **Rradhime, Vlore, pasuria me nr.0000-102/1/1 Z.K.3140.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqipërisë, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

- Hoteleri -Turizem, Bar-Restorant , etj,
- Import-Eksport te pajiseve te hotelerise,guzhines, mobilimet si dhe cdo lloj produkti

nga te gjitha vendet e botes perfshire dhe tregetim te tyre.

- Agjensi te sherbime komisionere, veprimtari te agjentit te transferimit te parave, ,Import export veshjesh e konfeksione te ndryshme ,aksesor,materiale druri, konsulenca ne fushen e ndertimit, Shitje artikuj te ndryshem me shumice e pakice, , transport brenda vendit mallrash, „Bar-kafe, agjensi turistike , agjensi udhetimi, ndertim per vete e per te trete, konstruksione te te gjitha llojeve, Agjent i transferimit te parave me dhe per llogari te subjektit financiar jo-banke, ,Shitje me shumice e pakice veshjesh e konfeksione te ndryshme ,sherbime te ndryshme ne fushen e telekomunikacionit dhe te informatikes ,veprimtari komisionere, tregeti me shumice dhe pakice te lendeve te para dhe mallrave produkt i gatshem ushqimor e ne regjistri, pije po dhejo alkoolike ,duhan dhe cigare, industriale te te gjitha llojeve elektroshtepiake dhe elktrokulturore ,bujqesore ,blegtorale dhe bime medicinale ,prodhim dhe tregtim konfeksionesh, lende ndertimi dhe paisje higjeno-sanitare, ne fushen e informatikes; perpunim druri; agjensi shitje-blerje dhe dhenie me qera te pasurive te paluajtshme; transport mallrash toksor dhe detar per vete dhe per te trete; si dhe cdo aktivitet tjeter i cili nuk biendesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi..
- Shoqeria mund te bashkepunoj edhe me shoqeri te tjera me te njejtin objekt te njejte ose te ndryshem nga i saj, si dhe cdo aktivitet tjeter i cili nuk biendesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000,00 lekë(dhjetë mije leke), i perbere nga “ (dy) kuota.

Kapitali i shoqerise eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht nga ortakët e shoqerise perkatesisht :

- Z.Xhemail Fazliu, zoterues te 1 kuote, me vlere 5.000,00 leke, qe perfaqeson me 50,00% te kuotave te kapitalit.
- Znj.Albana Dervishi, zoterues te 1 kuote, me vlere 5.000,00 leke, qe perfaqeson me 50,00% te kuotave te kapitalit.



Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet :

- kontributeve të reja në natyrë ose në para,
- kalimit të rezervave të disponueshme dhe fitimet e pashpërndara,

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, mbledhja e ortakut të vetëm mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar ose përtej një vlere më të lartë të rezervës së përcaktuar në statut, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.

Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Regjistrimi i vendimit për zmadhimin e kapitalit, duhet të shoqërohet nga bilanci, në bazë të të cilit është zmadhuar kapitali, nga konfirmimi i ekspertit kontabël të autorizuar dhe pasqyra e fundit e të ardhurave dhe e shpenzimeve

Njoftimi për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit duhet të përcaktojë se zmadhimi i kapitalit është kryer me kalimin e rezervave të shoqërisë ose me fitimin e pashpërndarë.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit


Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Ky vendim duhet të publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treta jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë të shoqërisë, sipas modaliteteve dhe shumices së cilesuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

2.Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët dhe, në rastet e parashikuara nga ligji, nga anëtarët e këshillit të administrimit, të këshillit mbikëqyrës apo nga aksionarët e përcaktuar sipas nenit 139 të ligjit 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “ i ndryshuar:

3.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

4.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.



5.Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

6. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asamblesë së përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabël i autorizuar i pavarur.

7.Dispozita e pikës 6 të këtij neni nuk zbatohet nëse blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kryhen në bursë apo janë pjesë e veprimeve të përditshme të shoqërisë dhe bëhen në kushte normale tregu.

8.Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo kritikuar veprimtarinë e organeve administrative.

9. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta



ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit 9901 date 14.04.2008 i ndryshuar.

Neni 12

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 13

Pjesëmarrja dhe votimi

1. Ky Statut parashikon për ortakët, që nuk janë të pranishëm, mundësinë e pjesëmarrjes në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve.

Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

- a) transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale;
- b) komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër;
- c) mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje.

2. Përdorimi i mjeteve elektronike, për t'u mundësuar ortakëve të marrin pjesë në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, bëhet me kushtin që të merren masat teknike të nevojshme për të garantuar identifikimin e ortakëve dhe sigurinë e komunikimeve elektronike, deri në atë masë që kypërdorimi i tyre të jetë proporcional me arritjen e këtyre qëllimeve.

3. Ortakët kanë të drejtë që u njihet nga ky ligj apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 14

Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat



kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " i ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " i ndryshuar.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 15

Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për :
 - a) ndryshimet e statutit;
 - b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - c) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - d) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - e) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - ë) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - f) shpërndarjen e fitimeve
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si :
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - c) përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabel,
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - dh) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

Neni 16

Administrimi

Shoqeria do të administrohet nga nje administrator .

Administrator i shoqerise eshte Znj.Albana Dervoishi, atesia Justinian, me datelindje 01.09.1984. lindur në Berat dhe banuese në adresën: Rruga "Muhamet Deliu", Tiranë, e pajisur me Letërnjoftim ID me Nr Personal:1459010064N, e cila do të ushtroje detyrat e administrimit të shoqerise per nje periudhe 5 vjeçare me te drejte ripërteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar asamblesë së përgjithshme. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e

përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit t", të ndryshuar.

Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji".

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit .

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administrator i shoqërisë mund të emerohet edhe nje person jashte ortakërisë.

Neni 17

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit te zakonshem të veprimtarisë tregtare së shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem,
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara ortakut në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme të rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve, zyrat e tatim taksave, doganave, zyrave te qeverisjes vendore etj.

Administratori nuk ka te drejte te nenshkruaje kontrata huaje, hipoteke, pa marre me pare miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve.

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që

rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Neni 18

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Administratorët detyrohen:

a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdhis;

b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në ligj ose dispozita;

c) të vlerësojnë me pergjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojnë dhe menjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji;

dh) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, pergjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata pergjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

a) u kthejnë ortakëve kontributet;

b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;


c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

ç) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) japin kredi.

Neni 19

Viti Financiar



Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 20

Rezerva ligjore dhe rezervat e tjera

1. Nga fitimi pas tatimit, te realizuar gjate vitit financiar paraardhes, duke zbritur shpenzimet, shoqeria duhet te kaloje ne rezerven ligjore, te paktën 5 për qind të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, apo me një vlerë më të lartë, të përcaktuar në statut.
2. Asambleja e Aksionereve mund të parashikojë krijimin e rezervave të tjera nga fitimet vjetore.
3. Shoqëria llogarit e ndan dividendët, vetëm pasi nga fitimi vjetor të jenë zbritur shumat e caktuara për rezervat e përmendura në pikat 1 e 2 të këtij neni.

Neni 21


Deklarimi i dividendit

1. Dividendi është pjesa që i takon secilit aksionar nga vlera e fitimeve vjetore, e cila vendoset të shpërndahet nga asambleja e përgjithshme.
2. Fitimet vjetore llogariten në përputhje me parimet e përcaktuara nga ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
3. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon ndryshe, dividendi shpërndahet mes aksionarëve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë.
4. Në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 14 të ligjit 9901 DATE 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Asambleja e përgjithshme mund të vendosë që shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të mos u paguhet aksionarëve, që zotërojnë aksione të kategorive të veçanta, por këto shuma të përdoren për qëllime të tjera. Të drejtat e aksionarëve, sipas parashikimeve të statutit, mund të ndryshohen vetëm nëpërmjet një vendimi të marrë me tre të katërtat e votave, sipas përcaktimit të nenit 145 ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 22

E drejta e shitjes

1. Ortakët kanë të drejtë të kërkojnë individualisht të tjetërsojnë me anë të shitjes kuotat e zotëruara nga secili prej tyre në Shoqëri.
2. Ortakët duhet të depozitojnë kërkesën e shitjes nëpërmjet një letre rekomande ku duhet të përcaktohet dhe çmimi i shitjes.




3. Në rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të transferojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e parablerjes por me të njëjtat kushte që do t'i bëhet të tretëve.
4. Nëse asnjëri nga ortakët nuk e ushtron të drejtën e parablerjes dhe shoqëria nuk komunikon vendimin e saj brenda 30 ditësh nga depozitimi i kërkesës, tjetërsuesi ka të drejtë t'i ofrojë me pëlqimin paraprak të shoqërisë, kuotën e vet një të treti por me të njëjtat kushte që i janë ofruar shoqërisë.
5. Çdo shitje e kuotave në kundërshtim me këto rregulla nuk duhet të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 23

Prishja e shoqërisë, shkaqet

Shkaqet e prishjes së shoqërisë janë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit 9901 date 14.04.2008;
 - d) kur, si pasojë e humbjeve ushtrimore, kapitalet e veta të shoqërisë janë në vlerë më të ulët se vlera minimale e kapitalit të regjistruar, të përcaktuar sipas nenit 107, të ligjit 9901 date 14.04.2008, apo kur vendoset zvogëlimi i kapitalit të regjistruar të shoqërisë nën këtë vlerë minimale dhe hyrja në fuqi e këtij zvogëlimi nuk kushtëzohet me realizimin e një zmadhimi vijues, nëpërmjet të cilit shoqëria të rikapitalizohet me kontribute të reja me vlerë, të paktën, sa vlera e nevojshme për të arritur kapitalin minimal të përcaktuar sipas atij neni;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - ë) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e aksionarëve.
2. Prishja e shoqërisë si pasojë e një apo më shumë prej shkaqeve të përcaktuara në përputhje me shkronjat "a", "c", "d", "dh", "e" dhe "ë", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga asambleja e aksionarëve me shumicën e parashikuar sipas pikës 1, të nenit 145, të ligjit 9901 date 14.04.2008.
3. Në rast mosveprimi të asamblesë së aksionarëve për të vendosur prishjen, sipas rasteve të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, në çdo kohë, për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve të parashikuara nga shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", të pikës 1, të këtij neni, nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkakun i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9723, datë



3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.

5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrëzimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.

6. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

Neni 24

Riorganizimi i shoqërisë

Shoqëria mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore.

Shoqëria mund të riorganizohet vetëm pasi ka qenë e regjistruara për të paktën një vit.

Shoqëria mund të bashkohet me një apo me shumë shoqëri nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëjës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivitetet e pasivitetet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 25

Ndarja

Shoqëria mund të ndahet me vendim të asamblesë së përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivitetet e pasivitetet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

Neni 26

Shndërrimi


Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit, si më poshtë:

a) shoqëria me pergjegjesi te kufizuar mund të shndërrohet në shoqëri aksionare; Shndërrimi nuk sjell pasojë mbi të drejtat e detyrimeve, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 27

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këto statute dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.



Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" ndryshuar me ligjin 129/2014, Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 28

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindin midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare sipas dispozitave te Kodit Civil.

Neni 28

Dispozita perfundimtare

Autorizohet administratore e shoqrise Znj.**Albana Dervishi** te depozitoje kete akt themelimi dhe statutin e shoqrise, prane Qendres Kombetare te Biznesit , si dhe te ndjeke te gjitha procedurat ligjore per regjistrimin e shoqerise.

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "**ALBAXHEM**" sh.p.k. ne bashkohet regullisht ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinitive sipas ligjit .



Z.Xhemail Fazliu

Znj.Albana Devishi

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 600 Rep.



VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 02 Mars 2018 (dymije e tetembehjete) përpara meje noteres Marsela Elmazaj me adrese ne Tirane , Bulevardi Bajram Curri, anetare e Dhomes se Noterise Tirane, u paraqiten personalisht :

- **Z.Xhemail Fazliu**, atesia Hajriz, dtl. 05.05.1965, lindur dhe banues ne Gjilan, Kosove, i paisur me e Republikes Kosoves , me nr P00620013, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.....
- **Znj.Albana Dervishi**, atesia Justinian, me datelindje 01.09.1984. lindur në Berat dhe banuese në adresën: Rruga "Muhamet Deiu", Tiranë, e pajisur me Letërnjoftim ID me Nr Personal:I459010064N, Te cilet me vullnetin e tyre të lire, të plote dhe të sinqërte, me cilesine e ortakeve themelues te shoqerise "**ALBAXHEM**" sh.p.k., kane redaktuar ne gjuhen shqipe, Statutin sa me siper dhe pasi e lexuan dhe e kuptuan, e nenshkruan pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale ne kete zyre para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994. " Per Noterin " ne Republiken e Shqiperise.

NOTERE
Marsela Elmazaj